



PROCESVERBAL III/2022

I mbajtur me rastin e mbledhjes së III (tretë) për vitin 2022 të Komitetit për Politikë dhe Financa të KK Suharekë

Vendi: KK Suharekë
Zyra: Salla e Bordit të Drejtorëve
Data: 22.03.2022
Ora : 13:00

Prezentë:

Z. Bexhet Kuçi - Kryesues
z. Urim Suka
znj. Bulëza Kuçi
znj. Sanie Kuçi Rexhepaj
znj. Fidaije Kukaj
z. Dardan Berisha
z. Liridon Fandaj

Të pranishëm tjerë:

Nënkryetarja e Komunës znj. Mihrije Suka
Habibe Bytyqi - zyrtare për barazi gjinore
Reshat Reshitaj - Zyrtar për informim
Përfaqësuesi i OSBE-së
Përfaqësuesi i LMT-së

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit z. Bexhet Kuçi i cili propozoi këtë:

Rend dite

- 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 2. Shqyrtimi i projekt - vendimit për miratimin e strategjisë për Zhvillim Ekonomikë Lokal;**
- 3. Shqyrtimi i projekt - vendimit për miratimin e raportit për vitin 2021, të komisionit komunal "Stacioni i Autobusëve" SH.A.;**
- 4. Shqyrtimi i projekt - vendimit për dhënien e pëlqimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës;**
- 5. Shqyrtimi i projekt - vendimit për miratimin llogarisë përfundimtare të të ardhurave dhe shpenzimeve të buxhetit të Komunës së Suharekës për periudhën Janar - Dhjetor 2021;**

Kryesuesi - përshëndet të pranishmit. I njofton të pranishmit se është një pikë shtesë në rend dite, ku kërkohet me inicu procedurën Kryetari për themelimin e një Ndërmarrje Publike Lokale. Kjo ndërmarrje publike po kërkohet sepse po lindin disa probleme në projekte dhe për një problem të vogël detyrohemi të hapim tender. Pra kjo Ndërmarrje Publike do jetë aset i Komunës dhe do merret me sanime të investimeve kapitale.

Liridon Fanadaj - deri sa janë dy njesi të kompanive regjionale, e mbeturinave dhe e ujës jellësit, mendoj që nuk duhet të krijohet një kompani Publike në kuadër të komunës kur e njëjta mundet mi krye ato shërbime.

Kryesuesi - Eko regjioni e ka pastrimin, Hidro regjioni e ka ujin, ndërsa kjo do merret me sanime.

Liridon Fanadaj - më mirë me ja dhënë një kompanie ekzistuese apo me kriju një ndërmarrje dhe me kriju një barrë për buxhetin e Komunës. Kjo më duket jo efektive.

Urim Suka - Është mirë të largohet kjo praktikë, sepse sa herë vim në mbledhje, vje një pikë e re në rend dite. Vetëm nëse është një vendim urgjent, por kjo nuk është urgjente. Sa i përket themelimit të ndërmarrjes, buxheti mundet me pas barrë por në anën tjetër ndoshta krijohet mundësi e punësimit, edhe pse mendoj që ka mundësi me u bo edhe me kontratë. Unë kërkoj që nëse është mundësia me e trajtua mbledhjen e ardhshme.

Nënkryetarja - Arsye e vonës që nuk ka ardh më herët, ka qenë për shkak të emrit të kësaj kompanie. Ju vendosni, por themelimi i kësaj ndërmarrje është një gjë e mirë.

Avni Bytyqi - si zyrtar ligjor jep sqarime shtesë për procedurat rreth themelimit të Ndërmarrjes Publike.

Sa i përket buxhetit, unë mendoj që ka me kontribu në Komunë sa i përket uljes së kostove të shpenzimeve rreth mirëmbajtjes së ambientit dhe hapësirave publike, për arsye se Komuna jonë i paguan rreth 60 mijë euro çdo vit Eko Regjionit për mirëmbajtjen e hapësirave publike.

Urim Suka - me na ardh tash, ne do të biem në lajthitje. Nuk kemi njohuri të mjaftueshme në fushën e kësaj veprimtarie. Ju them që për krejt praktikën që vin nesër, të na bini sa ma pak këso vendime, vetëm nëse është urgjente.

Dardan Berisha - nuk është që dua ta mbroj këtë projekt-vendim, por ne mund të propozojmë pika shtesë brenda kuadrit të Asamblesë për raste emergjente. Po sa po e shoh nuk qenka aq emergjente, paska procedura. Sa për fillim unë e përkrahi.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën shtesë.

**4 për, 3 abstenime,
Miratohet pika shtesë**

Kryesuesi - e hedh në votim rendin e ditës me pikën shtesë.

**4 për, 3 abstenime,
Miratohet**

Pika 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 1.

Miratohet Unanimisht

Pika 2. Shqyrtimi i projekt - vendimit për miratimin e strategjisë për Zhvillim Ekonomikë Lokal;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

Sanie Kuçi Rexhepaj - përshëndet të pranishmit. Pjesë e këtij projekti kam qenë edhe unë në një periudhë kohore. Shikova planin por kam një vërejtje: Meqenëse dokumenti ka marrë të dhëna nga PZHK, agjencioni i statistikave të Kosovës apo kushdo çoftë që ka marrë informata, të dhëna apo statistika, të mirret për bazë referenca se ku është bazu që i ka marrë ato.

Dardan Berisha - nëse i referohemi këtij drafti, mendoj që duhet me qenë anëtar i këtij komisioni Drejtori i Arsimit dhe i QPS-së. Mendoj që prioritet do të ishte edhe sporti. Poashtu ishin 4 qendra rinore në Suharekë. Unë nuk e di që janë 4 qendra.

Urim Suka - ne si LDK e mbështesim çdo nismë e cila investimet në Komunë i ka për strategji të zhvillimit ekonomikë lokal. Përpjekjen për një strategji e shohim si të mirë dhe e mbështesim. Kjo strategji ka gjëra që ka parapa, por është për çudi, sa që është vështirë e implementueshme. Është mirë me qenë pak ma konkrete dhe reale, kështu që mundet edhe me u implementu. Te sektori i bujqësisë kjo strategji parasheh shumë investime. Por për katër vite, ju gjysmën e buxhetit e keni qu në rrugë fushore, dhe donacionet kanë qenë zero. Fjalën përfundimtare e japim në Asamble.

Dardan Berisha - mendoj që çdo fundvit duhet ta kemi nga një raport të kësaj strategjie.

Avni Bytyçi - si grup punues kam qenë edhe unë dhe çdo herë kam kërkuar që kjo strategji të miratohet pas miratimit të PZHK-së, sepse orientimin dhe bazën e ka PZHK -ja. Unë mendoj që kjo është një lloj letërnjoftimi i Komunës. Ai më tej vazhdon me sqarimet si zyrtar ligjor.

Urim Suka - mënyra si është investu deri tash është për me të ardh keq. Si strategji e mbështesim por kjo këtu nuk të len për me dëshiruar.

Sanie Kuçi Rexhepaj - Komuna e Suharekës mbas luftës, është një ndër Komunitat e para e cila e ka hartu PZHK-në. PZHK është ma afatgjatë dhe ky është afatmesëm dhe i elaboron pak më shumë planet apo prioritetet strategjike të cilat e zhvillojnë Komunën.

Urim Suka - Nuk është mirë me marrë përsipër dhe me mbrojtë diçka, që e dini që është e keqe.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën e dytë.

Unanimisht Miratohet

Pika 3. Shqyrtimi i projekt - vendimit për miratimin e raportit për vitin 2021, të komisionit komunal "Stacioni i Autobusëve" SH.A.;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

Liridon Fandaj - Në raport thuhet se stacioni i autobusëve nuk i ka obligim asnjë furnitori dhe asnjë institucioni. Dhe këtu në kalkulim del që është minus. Në raport u deshtë pasqyrat financiare mi pas.

Kryesuesi - nuk ka pas të hyra shumë, për shkak të Kovid-it.

Liridon Fandaj - si i ka bo këto shpenzime ?

Kryesuesi - shpenzimet janë të pagave më tepër.

Liridon Fandaj - a i ka obligim dikujt, sepse është minus.

Kryesuesi - jo nuk i ka. Të hyrat që i ka parapa në baz të hyrjeve të autobusëve, është minus.

Liridon Fandaj - duhet me pas një raport financiar sepse është ndërmarrje komunale.

Avni Bytyçi - duhet të dimë që stacioni i autobusëve është aksionar Komune 100 % .Dhe nese vërtetë janë minus, ka mundësi këtë vit ata me bo kërkesë dhe me ja mbuluar shpenzimet.

Liridon Fandaj - nëse unë nuk e ngris si çështje dhe e miratoj, neser të vje një kërkesë me ja mbulu shpenzimet.

Avni Bytyçi - në Asamble do të jetë kryeshefi i ndërmarrjes me raportu.

Liridon Fandaj - për mu ky raport nuk kalon.

Dardan Berisha - ne në Asamble e kemi formu një komision, dhe është mirë me informua atë komision për këtë, që në një formë më të detajuar le të ipen shpenzimet konkrete, sepse përveç saj shqetësuese mbetet edhe keqpërdorimi i lokaleve të lëshuara me qera.

Kryesuesi - këta janë firmë shërbyese dhe planifikojnë të hyra. Sepse ata e din sa autobusa hyjnë. Mirëpo ka ndiku edhe pandemia dhe disa vija janë ndal. Për fat të mirë kanë pas një rezerve, dhe ajo i ka mbajtur.

Urim Suka - unë nuk jam shumë ekspert për me i kalkuluar, por është dashtë me u përgatit një raport më i detajizum.

Kryesuesi - e hedh në votim.

4 për, 3 kundër, Miratohet pika 3

Pika 4. Shqyrtimi i projekt - vendimit për dhënien e pëlqimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

Urim Suka - kërkoj sqarim. A ka bazë ligjore ky vendim, a është e lirë kjo pronë? Nëse nuk është e lirë, a kemi të drejtë ligjore me dhanë?

Armend Krasniqi - detyrat e Komunave është që të menaxhojnë në mënyrë sa më të mirë për të gjitha tokat që i posedojnë dhe nga ky aspekt të përfitojnë dhe ti kthejnë ato prona në përfitime ekonomike. Prona në Duhel, është analizu dhe e kemi shqyrtu. Ka dal që është pronë komunale. Kjo pronë duhet të zhvillojë procedura në mënyrë që të jepet në shfrytëzim.

Urim Suka - pyetja ime ishte, që kjo pronë që po na ipet me dhanë pëlqimin, a kemi të drejtë ligjore me dhanë pëlqimin për një pronë e cila aktualisht është duke u shfrytëzua dhe nuk është e lirë?

Armend Krasniqi - faktikisht ajo pronë është e uzurpune në vitet 2000-2001-2002 kur ka menaxhu LDK-ja. Ne ose duhet mi zgjidh këto probleme ose kemi me lan pasoja në të ardhmen.

Urim Suka - unë them, a kemi të drejtë me dhanë nëse prona është e uzurpune.

Avni Bytyçi - jo nuk kemi të drejtë.

Urim Suka - tërheqne këtë pikë dhe mos na bini situata të tilla.

Avni Bytyçi - a është e uzurpuar, unë dhe Kryesuesi nuk kemi informacione. A duhet të jetë e lirë prona nga palët e treta për të zhvillu procedurë në ankand publik, definitivisht duhet me qenë e lirë.

Urim Suka - pe shoh problem. Sepse, nëse unë e kam uzurpu një pronë dhe ti ma legalizon me kërkesa e të njohfshëm, atëherë krijon përshtypje,që njerëzit munden me uzurpu. Se masanej i legalizon Balia ose tjetri.

Liridon Fandaj - nëse unë nesër konkurroj dhe e marr,a ma lirojnë pronën?

Armend Krasniqi - patjetër që po.

Avni Bytyçi - së pari duhet të lirohet e masanej e qet në ankand.

Dardan Berisha - nëse ne e marrim një vendim, është i ligjshëm ky vendim. Atëherë vazhdon me procedurat tjera.Ai le ti përcjell procedurat tjera gjyqësore,qysh e ka marrë dhe le ta mbron.

Kryesuesi - e hedh në votim.

**5 për, 2 kundër
Miratohet pika 4**

Pika 5. Shqyrtimi i projekt - vendimit për miratimin llogarisë përfundimtare të të ardhurave dhe shpenzimeve të buxhetit të Komunës së Suharekës për periudhën Janar - Dhjetor2021;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

Urim Suka - pata qef me qen Kryetari,sepse mbledhjen e fundit ka thënë: bartje ka, por suficit s'ka.

Kryesuesi - e hedh në votim.

Unanimisht Miratohet

Pika 6. Shqyrtimi i projekt-vendimit për fillimin e nismës së procedurës për themelimin e Ndërmarrjes Publike Lokale;

Kryesuesi - e hedh në votim pikën shtesë.

**4 për, 3 abstenime
Miratohet**

Kryesuesi - e kemi një pikë shtesë nga drejtorja e urbanizmit,e cila është shumë e rëndësishme. Kërkohet vetëm pëlqim për shqyrtim për harata zonale.

Sanie Kuçi Rexhepaj - dokumenti i dytë i rëndësishëm në Komunë është Hartat Zonale,e cila i definon kushtet e ndërtimit .Unë kisha thënë ta fusim në rend dite dhe ta përcjellim për Asamble.

Avni Bytyçi – Vërtet kjo pikë është e karakterit urgjent dhe se paska ardhur pëlqimi nga MPMHI-së për ta vene ne shqyrtim publik Hartën zonale te Komunës dhe se është mirë te votohet dhe te përcillet për Kuvend.

Kryesuesi - e hedh në votim.

Unanimisht Miratohet

Takimi përfundoi: **14:15**

Procesmbajtësja :
Dafina Haziraj